15. Nje perberje farmaceutike qe permban nje acid nukleik te ndonjerit prej pretendimeve 1-13 qe qe permban me tej nje mjet shperndares, preferohen liposome dhe/ose nje eksipient te pranueshem fiziologjikisht dhe/ose nje bartes dhe/ose nje diluent.

(11) **11375**

(97) EP3767875 / 21/12/2022

(96) 19382602.1 / 16/07/2019

(22) 23/01/2023

(21) AL/P/ 2023/37

(54) **METODË PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK TË KONTRATAVE**

10/05/2023

(30)

(71) Lleidanetworks Serveis Telemàtics, S.A.

Parc Científic i Tecnològic, Agroalimentari de Lleida, 25003 Lleida, ES

(72) SAPENA, Francisco (LLEIDANETWORKS SERVEIS TELEMATICOS, S.A., CEO Parc Científic i Tecnològic Agroalimentari de, Lleida, 25003 Lleida); SOLA, Carolina (Parc Científic i Tecnològic Agroalimentari, de Lleida, Edifici H1 2a planta B, 25003 Lleida)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një metodë për nënshkrimin elektronik të kontratave midis të paktën një pale të parë dhe një të dytë, ku metoda përfshin palën e parë që akseson plotësimin e një formulari në internet nga serveri i një pale të dytë, ku metoda përfshin:

a. serverin e palës së dytë:

i. përpilimin e të dhënave personale të ofruara nga pala e parë, së bashku me kushtet e përgjithshme të kontratës,

ii. krijimin e një identifikuesi unik (ID),

iii. përfshirjen e identifikuesit unik në fjalë (ID) në kontratë,

iv. krijimin e një çelësi të randomizuar që shifron kontratën,

v. shifrimin e çelësit të randomizuar në fjalë me një çelës publik pale të tretë të besuar (TTP) të një çifti çelësash publik-privat TPP, ku çelësi publik është i certifikuar dhe i shpërndarë siç duhet, dhe çelësi private mbahet i fshehtë brenda palës së tretë të besuar (TTP),

vi. llogaritjen e një kodi hash H(ID)

vii. dërgimin e kontratës së shifruar, çelësit të randomizuar e të shifruar dhe kodit hash H(ID) te pala e tretë e besuar (TTP),

b. TTP që vendos kontratën e shifruar në një server aksesi publik dhe dërgon URL e serverit me akses publik te serveri i palës së dytë,

c. serveri i palës së dytë që dërgon URL e serverit me akses publik dhe çelësin e randomizuar te pala e parë,

d. pala e parë që shkarkon nga pala e tretë e besuar (TTP), deshifron dhe akseson kontratën duke përdorur çelësin e randomizuar,

e. pala e tretë e besuar (TTP) që merr ID nga pala e parë brenda kontratës së shifruar dhe krahason kodin hash të ID në fjalë kundrejt kodit H(ID) të marrë nga serveri i palës së dytë dhe krijon një evidencë se kontrata është aksesuar nga pala e parë nëse përkojnë kodet hash,

f. nëse kodet hash përkojnë, pala e tretë e besuar (TTP) që krijon dhe dërgon një SMS ose një email që përmban një fjalëkalim njëpërdorimësh (OTP) te pala e parë,

g. pala e parë që i përgjigjet SMS-së ose emailit të dërguar nga pala e tretë e besuar (TTP) duke futur OTP e marrë që tregon dakordësinë e palës së parë me kontratën,

h. pala e tretë e besuar (TTP) që merr dhe kontrollon vlefshmërinë e OTP,

i. me verifikimin e OTP, pala e tretë e besuar (TTP) që përpilon të gjithë informacionin teknik dhe krijon një dokument-certifikatë që përfshin:

i. kontratën e shifruar,

ii. çelësin e randomizuar të shifruar,

iii. ID në formë hash,

iv. një ID të palës së parë,

v. numrin e telefonit ose emailin të cilit i është dërguar OTP, dhe

vi. orën në të cilën është krijuar OTP e konfirmimit.

j. vulosjen kohore të dokumentit-certifikatë dhe ruajtjen e dokumentit-certifikatë me vulë kohore në sistemin informatik të palës së tretë të besuar (TTP).

2. Metoda e pretendimit 1 ku faqja e internetit hostohet në një IP që përfshin domenin IP të palës së dytë.

3. Metoda e pretendimit 1 ku OTP transmetohet me numër telefoni ose email.

4. Metoda e pretendimit 1 ku pala e tretë e besuar (TTP) lidhet me serverin e palës së dytë duke përdorur një VPN (rrjet privat virtual).

5. Metoda e pretendimit 1 ku çelësi privat i çiftit të çelësave publik-privat të palës së tretë të besuar (TTP) ruhet i fshehtë nga një grup shumë i kufizuar personash tejet të besuar brenda TTP.

(11) **11376**

(97) EP3849976 / 26/10/2022

(96) 19765747.1 / 13/09/2019

(22) 24/01/2023

(21) AL/P/ 2023/39

(54) **NJË LIGAND I RECEPTORIT GABA A**

10/05/2023

(30) 18194297 13/09/2018 EP

(71) Saniona A/S

Smedeland 26B, 2600 Glostrup, DK


(72) JACOBSEN, Thomas, Amos (c/o Saniona A/S, Smedeland 26B, 2600 Glostrup); NIELSEN, Karin, Sandager (c/o Saniona A/S, Smedeland 26B, 2600 Glostrup); LARSEN, Janus, S. (c/o Saniona A/S, Smedeland 26B, 2600 Glostrup); AMRUTKAR, Dipak (c/o Saniona A/S, Smedeland 26B, 2600 Glostrup); DYHRING, Tino (c/o Saniona A/S, Smedeland 26B, 2600 Glostrup)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një përbërje e formulës 1:



1

ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj.

2. Një kompozim farmaceutik që përfshin një sasi terapeutikisht aktive të përbërjes së përcaktuar në pretendimin 1.

3. Përbërja e përcaktuar në pretendimin 1 për përdorim në mjekësi.

4. Përbërja e përcaktuar në pretendimin 1 për përdorim në trajtimin e dhimbjes neuropatike.

5. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4, ku dhimbja neuropatike është alodinia.

6. Përbërja e përcaktuar në pretendimin 1 për përdorim në trajtimin e kruarjes.

7. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 6, ku kruarja është *Pruritus*.

8. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 6, ku kruarja është shkaktuar nga një gjendje e lëkurës.
9. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 8, ku gjendja e lëkurës është psoriaza.
10. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 8, ku gjendja e lëkurës është ekzema.

(11) **11377**

(97) EP3710437 / 14/12/2022

(96) 18816112.9 / 18/12/2018

(22) 24/01/2023

(21) AL/P/ 2023/40

(54) **NDARJA ENANTIOMERIKE E NIKOTINËS RACEMIKE ME ANË TË SHTIMIT TË NJË ENANTIOMERI TË ACIDIT TARTARIK TË O,O'-DIZËVENDËSUAR ME PASTËRTI OPTIKE TË ULËT**

10/05/2023

(30) 17210181 22/12/2017 EP

(71) Siegfried AG and Contraf-Nicotex-Tobacco GmbH

Untere Brühlstrasse 4, 4800 Zofingen, CH ;Herbststraße 8, 74072 Heilbronn, DE


(72) WEBER, Beat (Wiesenstrasse 4, 4800 Zofingen) ;PAN, Ben (Hongyang Building 4 Room 1403, East Youth Road, Nantong Chongchuan Area, Jiangsu Province, 226001)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri


(57)

1. Një metodë e përgatitjes së një përbërje të Formulës I-b, që përfshin



(I-b)

sigurimin e nikotinës së Formulës I-a si një përzierje e enantiomerit-(R) dhe -(S)



(I-a);

ndarjen e enantiomereve të përbërjes së Formulës I-a me anë të shtimit të një acidi tartarik kiral të O,O'-dizëvendësuar, ku acidi tartarik kiral i O,O'-dizëvendësuar përfshin L-enantiomerin; dhe përfitim të përbërjes së Formulës I-b, ku acidi tartarik i O,O'-dizëvendësuar është një përzierje e L-enantiomerit dhe D-enantiomerit, ku raporti molar i L-enantiomerit ndaj D-enantiomerit është 90:10 ose më shumë dhe 95:5 ose më pak, dhe ku shtimi i acidit tartarik kiral të O,O'-dizëvendësuar është kryer me etanolin si tretës.

2. Metoda e pretendimit 1, ku acidi tartarik kiral i O,O'-dizëvendësuar është zgjedhur nga acidi tartarik O,O'-dibenzoil (DBTA) dhe acidi tartarik O,O'-ditoluil (DTTA).

3. Metoda e pretendimit ose 2, ku acidi tartarik i O,O'-dizëvendësuar është një përzierje e acidit tartarik O,O'-dibenzoil-L (L-DBTA) dhe acidit tartarik O,O'-dibenzoil-D (D-DBTA) me një raport molar të L-DBTA ndaj D-DBTA prej 90:10 ose më shumë dhe 95:5 ose më pak.

(11) **11378**

(97) EP3298030 / 18/01/2023

(96) 16729794.4 / 18/05/2016

(22) 27/01/2023

(21) AL/P/ 2023/46

(54) **POLYPEPTIDI I BASHKIMIT ANTI-KANCER**

11/05/2023

(30) 15167927 18/05/2015 EP and 16150508 08/01/2016 EP

(71) Pieris Pharmaceuticals GmbH

Lise-Meitner-Strasse 30, 85354 Freising-Weihenstephan, DE

(72) HINNER, Marlon (Eugen Papststrasse 9, 81247 Munich); BEL AIBA, Rachida, Siham (Erhardtstrasse 15, 80469 Munich); ROTHE, Christine (Heinrich-Nikolaus-Strasse 26, 85221 Dachau); OLWILL, Shane (Am Waldrand 23a, 85354 Freising) ;SCHLOSSER, Corinna (Angerstr. 18C, 85354 Freising)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një proteinë bashkimi e karakterizuar në atë

që proteina e bashkimit është e aftë të lidhë të dy CD137 dhe glipikan-3 (GPC3), dhe që proteina e bashkimit përfshin të paktën dy nënnjësi në çdo mënyrë, nënnjësia e parë përfshin një muteinë të lipokalinës specifike për CD137 që ka të paktën 85% identitet sekuece me një sekuecë të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOS: 18-33 dhe nënnjësia e dytë përfshin një imunoglobulinë me gjatësi të plotë, një domen antigjen-lidhës të saj, ose një muteinë të lipokalinës specifike për GPC3.

2. Proteina e bashkimit e pretendimit 1, ku nënnjësia e dytë përfshin një muteinë të lipokalinës që ka specifike lidhëse për GPC3.

3. Proteina e bashkimit e pretendimit 2, ku proteina e bashkimit më tej përfshin një nënnjësi të tretë e cila është

- (i) një fragment i imunoglobuliës-Fc,
- (ii) specifike për CD137, ose
- (iii) një muteinë të lipokalinës që ka specifike lidhëse për CD137.

4. Proteina e bashkimit e pretendimit 2 ose 3, ku

muteina e lipokalinës që ka specifike lidhëse për GPC3 përfshin një sekuecë amino acide që ka të paktën 85% identitet sekuece me një sekuecë të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOS: 4-17, ose që ka të paktën 90% identitet sekuece me një sekuecë të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOS: 4-17, ose që ka të paktën 95% identitet sekuece me një sekuecë të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOS: 4-17, ose që është zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOS: 4-17.

5. Polipeptidi i bashkimit i çdo njërit prej pretendimeve 1-4, ku

muteina e lipokalinës që ka specifike lidhëse për CD137 përfshin grupin e mëposhtëm të mbetjeve amino acide të mutuara në krahasim me sekuecën lineare të polipeptidit të hNGAL të maturuar (SEQ ID NO: 2):

Gln 28 → His; Leu 36 → Gln; Ala 40 → Ile; Ile 41 → Arg; Gln 49 → Ile; Tyr 52 → Met; Asn 65 → Asp; Ser 68 → Met; Leu 70 → Lys; Arg 72 → Asp; Lys 73 → Asp; Asp 77 → Met; Trp 79 → Asp; Arg 81 → Trp; Cys 87 → Ser; Asn 96 → Lys; Tyr 100 → Phe; Leu 103 → His; Tyr 106 → Ser; Lys 125 → Phe; Ser 127 → Phe; Tyr 132 → Glu; dhe Lys 134 → Tyr.

6. Proteina e bashkimit e çdo njërit prej pretendimeve 1-5, ku

- (i) muteina e lipokalinës që ka specifike lidhëse për CD137 ka të paktën 90% identitet sekuece me një sekuencë amino acide të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOs: 18-33;
- (ii) muteina e lipokalinës që ka specifike lidhëse për CD137 ka të paktën 95% identitet sekuece me një sekuencë amino acide të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOs: 18-33; ose
- (iii) muteina e lipokalinës që ka specifike lidhëse për CD137 përfshin një sekuencë amino acide të zgjedhur nga grupi i përbërë prej SEQ ID NOs: 18-33.

7. Proteina e bashkimit e çdo njërit prej pretendimeve 1-6, ku polipeptidi i bashkimit përfshin sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 48 ose sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 49.

8. Proteina e bashkimit e çdo njërit prej pretendimeve 1-7, ku imunoglobulina është një antitrop monoklonal.

9. Proteina e bashkimit e pretendimit 8, ku

- (a) antitropi monoklonal ka një shtyllë IgG4, ku opsionalisht shtylla IgG4 ka çdo njërin prej mutacioneve të mëposhtme të zgjedhura nga grupi i përbërë prej S228P, N297A, F234A, dhe L235A; ose
- (b) antitropi monoklonal ka një shtyllë IgG2, ku opsionalisht shtylla IgG2 ka çdo njërin prej mutacioneve të mëposhtme të zgjedhura nga grupi i përbërë prej N297A, F234A, dhe L235A.

10. Proteina e bashkimit e çdo njërit prej pretendimeve 1-9, ku proteina e bashkimit përfshin sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 44, sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 45, sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 46, ose sekuencën amino acide të treguar në SEQ ID NO: 47.

11. Një molekulë e acidit nukleik që përfshin një sekuencë nukleotide që kodon proteinën e bashkimit të çdo njërit prej pretendimeve 1-10.

12. Një qelizë bartëse që përmban molekulën e acidit nukleik të pretendimit 11.

13. Një metodë *in vitro* e prodhimit të proteinës së bashkimit të çdo njërit prej pretendimeve 1-10, ku proteina e bashkimit është prodhuar duke filluar nga acidi nukleik që kodon për proteinën e bashkimit me anë të metodave të inxhinierisë gjenetike, ku opsionalisht proteina e bashkimit është prodhuar në një organizëm bartës bakterial ose eukariotik dhe është izoluar nga ky organizëm bartës ose kultura e tij.

14. Një proteinë bashkimi e çdo njërit prej pretendimeve 1-10 për përdorim në trajtimin e kancerit.

15. Proteina e bashkimit për përdorimin e pretendimit 14, që përfshin

- (i) aktivizimin njëkohësisht të rrugëve sinjalizuese të rrjedhës së poshtme të CD137 dhe angazhimin e qelizave të tumorit GPC3-pozitiv, që përfshin aplikimin e proteinës së bashkimit ose një kompozim që përfshin proteinën e tillë të bashkimit;

- (ii) bashkëstimulimin njëkohësisht të qelizave T dhe angazhimin e qelizave të tumorit GPC3-pozitiv, që përfshin aplikimin e proteinës së bashkimit ose një kompozim që përfshin proteinën e tillë të bashkimit;
- (iii) nxitjen njëkohësisht të proliferimit të limfociteve T dhe angazhimin e qelizave të tumorit GPC3-pozitiv, që përfshin aplikimin e proteinës së bashkimit ose një kompozim që përfshin proteinën e tillë të bashkimit; ose
- (iv) drejtimin e grupimit CD137 dhe aktivizimin e qelizave T të qelizave të tumorit GPC3-pozitiv, që përfshin aplikimin e proteinës së bashkimit ose një kompozim që përfshin proteinën e tillë të bashkimit.

16. Një kompozim farmaceutik që përfshin proteinën e bashkimit të çdo njërit prej pretendimeve 1-10.

(11) **11379**

(97) EP3883547 / 21/12/2022

(96) 21700361.5 / 05/01/2021

(22) 27/01/2023

(21) AL/P/ 2023/47

(54) **PËRGATITJA DHE PËRDORIMI I NANO-FORMULIMIT TË KANABISIT**

11/05/2023

(30) 20150397 06/01/2020 EP

(71) CannaXan GmbH

Birkerfeld 12, 83267 Warngau, DE

(72) BRAND, Werner (c/o CannaXan GmbH, Birkerfeld 12, 83627 Warngau)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një formulim që përfshin të paktën një material natyral kanabisi, të paktën një tretës dhe të paktën një stabilizues, ku formulimi është një suspension i lëngshëm që ka një madhësi grimce (D_{90}) nën 500 nm; ku të paktën një tretës është një përzjerje e ujit dhe një lipidi.

2. Formulimi i pretendimit 1, ku të paktën një material natyral i kanabisit është një material i familjes së *Cannabaceae*, në mënyrë të preferuar ku materiali natyral i kanabisit është një material i një gjinie të zgjedhur nga grupi që përbëhet nga *Aphananthe*, *Canabis*, *Celtis*, *Chaetachme*, *Gironniera*, *Humulus*, *Lozanella*, *Parasponia*, *Pteroceltis* dhe *Trema*, dhe në mënyrë të preferuar ku materiali natyral i kanabisit është një material i gjinisë *Canabis*.

3. Formulimi sipas pretendimit 2, ku të paktën një material natyral i kanabisit është një material i gjinisë *Canabis*, dhe ku *Canabisi* është një specie e zgjedhur nga grupi që përbëhet nga *Canabis sativa*, *Canabis indika* dhe *Canabis ruderalis*, në mënyrë të preferuar ku të paktën një material natyral i kanabisit është një material i species *Canabis sativa*.

4. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku të paktën një material natyral i kanabisit është një pjesë ose e tërë e materialit natyror të kanabisit në fjalë, në mënyrë të preferuar ku pjesa e materialit natyror të kanabisit në fjalë është zgjedhur nga grupi që përbëhet nga gjethja, kërcelli, fara, lulja, rrënja dhe përzjerjet e tyre, dhe ku në mënyrë të preferuar materiali natyral i kanabisit përfshin ose është një lule e materialit natyror të kanabisit në fjalë.

5. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku të paktën një material natyral i kanabisit është i shpërndarë në formulim në një sasi nga 0.1 deri në 20 % (w/w), bazuar në masën totale të formulimit në mënyrë të preferuar nga 0.1 deri në 10 % (w/w), në mënyrë të preferuar nga 0.2 deri në 5 %

(w/w), në mënyrë të preferuar nga 0.3 deri në 4 % (w/w), në mënyrë të preferuar nga 0.5 deri në 3 % (w/w), më tej në mënyrë të preferuar nga 0.5 deri në 1% (w/w), nga 1 deri në 2% (w/w), ose nga 2 deri në 4% (w/w), bazuar në masën totale të formulimit.

6. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku formulimi përfshin të paktën një tretës tjetër të zgjedhur nga grupi i përbërë nga etanoli, një lipid, një tretës organik jopolar dhe një përzierje e tyre.

7. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku lipidi është zgjedhur nga grupi i përbërë nga një lipid i ngurtë, lipid i lëngshëm, dyllë dhe një përzierje e tyre, ku në mënyrë të preferuar lipidi është një përzierje e një lipidi të lëngshëm dhe një lipidi të ngurtë.

8. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku lipidi është një glicerid, në mënyrë të preferuar i zgjedhur nga grupi i përbërë nga monogliceride, digliceride ose trigliceride, ku në mënyrë të preferuar lipidi është një triglicerid, dhe ku në mënyrë më të preferuar gliceridi është një përzierje e një trigliceridi me zinxhir të mesëm dhe estereve të glicerines të acideve yndyrore të ngopura C₁₂-C₁₈ (Gelucire[®] 39/01).

9. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku stabilizuesi është zgjedhur nga grupi i përbërë nga fosfolipide; polisorbate; polimere që përfshijnë homopolimere, kopolimerë bllok dhe shartime (që përfshijnë hidroksipropil celulozë (HPC), hidroksipropil metilcelulozë (HPMC) dhe polivinilpirrolidon (PVP)); kopolimerët tre-blok jojonike që përfshijnë poloksamere; kopolivinilpirrolidoni; Labrasol[®]; xhelatinë; lecitin (fosfatidet); gomë akacie; gomë ksantan; gomë arabike; kolesterol; tragakante; polioksietilen alkil eteret; derivatet e vajit të ricinit polioksietilen; estere të acidit yndyror polioksietilen sorbitan; esteret e acideve yndyrore sorbitan; glikole polietileni; stearate polioksietileni; dioksid silikoni koloidal; dodecilsulfat natriumi; mono dhe digliceride; silikat alumini i magnezit; trietanolamine; acid stearik; stearat kalçiumi; monostearat glicerine; alkool cetostearil; dylli emulsifikues cetomakrogol; alkoole me zinxhir të shkurtër dhe të mesëm; Labrafil[®]; Purol-oleique; propan-1,2,3-triol (glicerine); alkool polivinil; sulfosukcinat dioktil natriumi (DOSS); natrium karmelloze; karragjene; karbomer; hipromeloze; dhe një përzierje e tyre.

10. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku stabilizuesi është zgjedhur nga grupi i përbërë nga fosfolipide, surfaktantë dhe polimere, ku në mënyrë të preferuar stabilizuesi është një polimer i zgjedhur nga grupi i përbërë nga polisorbate, polisakaride dhe poloksamere.

11. Formulimi sipas pretendimit 9 ose 10, ku formulimi përfshin një polisorbat si stabilizues në një sasi deri në 10 % (w/w), bazuar në masën totale të formulimit, në mënyrë të preferuar në një sasi prej 0.5 deri në 4.5 % (w/w), në një sasi nga 1 deri në 4.5 % (w/w), ose në një sasi nga 1.5 deri në 4 % (w/w), në mënyrë më të preferuar në një sasi nga 2 deri në 3 % (w/w), ose në një sasi prej 3 deri në 4% (w/w), dhe në mënyrë më të preferuar në një sasi prej 2.5 deri në 4% (w/w), dhe/ose ku formulimi përfshin një polisorbat si stabilizues i zgjedhur si polisorbat 80 (Tween[®] 80) ose polisorbat 20 (Tween[®] 20), në mënyrë të preferuar polisorbat 80 (Tween[®] 80).

12. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve 9 deri në 11, ku formulimi përfshin një poloksamer si stabilizues në një sasi deri në 10 % (w/w), bazuar në masën totale të formulimit, në mënyrë të preferuar në një sasi prej nga 0.2 deri në 1.5 % (w/w), në mënyrë më të preferuar në një sasi prej 0.5 deri në 1% (w/w), dhe/ose ku formulimi përfshin një poloksamer si stabilizues të zgjedhur si poloksamer 407 (Kolliphor[®] P407), ose poloksamer 188.

13. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve 9 deri në 12, ku formulimi përfshin një fosfolipid si stabilizues në një sasi prej 0.5 deri në 10 % (w/w), bazuar në masën totale të formulimit, në mënyrë të preferuar në një sasi nga 1 deri në 4 % (w/w), dhe/ose ku fosfolipidi përmban fosfatidilkoline nga 40 deri

në 100 (w/w), bazuar në masën totale të fosfolipidit, dhe/ose ku formulimi përfshin një fosfolipid si stabilizues të zgjedhur si Lipoid® P45.

14. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku formulimi përfshin më tej një ndihmës, ku në mënyrë të preferuar ndihmësi është zgjidhur nga grupi i përbërë nga konservuesit, antioksidantët dhe agjentët osmotikë.

15. Formulimi sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme për përdorim në kujdesin paliativ, dhe/ose në trajtimin ose zbutjen e një sëmundjeje, ku në mënyrë të preferuar sëmundja është zgjedhur nga grupi që përbëhet nga dhimbja, në veçanti dhimbja akute ose kronike, dhimbja somatike, dhimbja viscerele, dhimbja neuropatike, dhimbja e kancerit, dhimbja kronike e shpines, dhimbja nervore qendrore kronike; çrregullimet neurologjike, sëmundjet neurodegenerative, pagjumësia, çrregullimet psikiatrike, nauzea, anoreksia, të vjellat dhe të përzierat të shkaktuara nga kimioterapia, polineuropatia diabetike, fibromialgjia, sindroma Tourette, skleroza e shumëfishtë, spazma në sklerozë të shumëfishtë, çrregullimet e ankthit, skizofrenia, fobia sociale, çrregullimi i gjumit, sëmundjet e lidhura me lëkurën si psoriaza dhe neurodermatiti, glaukoma, sindroma e këmbëve të lodhura, epilepsia, sëmundja Alzheimer, sëmundja e lëvizjes si Distonia, sëmundja e Huntingtonit, sëmundja e Parkinsonit, si dhe indikacione të tjera mjekësore që janë të prekura nga sistemi endokannabinoid dhe që janë të prekura nga çdo receptor tjetër i prekur nga kanabinoidet (p.sh. GPR18, GPR119, GPR55).

(11) **11380**

(97) EP3945278 / 16/11/2022

(96) 21177839.4 / 04/06/2021

(22) 31/01/2023

(21) AL/P/ 2023/48

(54) **JELEK ANTIPLUMB**

11/05/2023

(30) 202000018718 31/07/2020 IT

(71) Alfredo Grassi S.p.A.

Via Vittorio Veneto 82, 21015 Lonate Pozzolo (VA), IT

(72) GRASSI, Roberto (, 20145 Milano (MI))

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Një jelek antiplumb (7) i dizenuar të mbulojë të paktën pjesërisht pjesën e parme, ose kraharorin, dhe pjesën e pasme, ose shpinën, e bustit të një përdoruesi, ku jeleku antiplumb (7) është bërë nga një veshje e vetme pa sisteme mbështetëse mbi supe dhe/ose në belin e përdoruesit dhe përmban:

- të paktën një shtresë të jashtme (12), të prodhuar me një pëlhurë të parë të endur elastike; dhe
- të paktën një shtresë të brendshme (14), të prodhuar me një pëlhurë të dytë të endur elastike dhe e dizenuar të hyjë në kontakt me lëkurën e përdoruesit,

ku ndërmjet të paktën dy porcioneve (14A, 14B) të pëlhurës së dytë të endur elastike të përmendur të shtresës së brendshme të përmendur (14) të paktën përftohet një xhep (16A, 16B) i cili është i pajisur me mjete fiksuese (26) dhe është dizenuar të përmbajë të paktën një paketim balistik përkatës (24), ku shtresa e jashtme e përmendur (12) dhe shtresa e brendshme e përmendur (14) janë të lidhura reciprokisht duke u ngjitur përgjatë një ose më shumë sipërfaqeve ngjitëse me forma (20), të ndërvendosura ndërmjet shtresës së jashtme të përmendur (12) dhe shtresës së brendshme të përmendur (14), ku jeleku antiplumb (7) karakterizohet në atë që ndërmjet shtresës

së jashtme të përmendur (12) dhe shtresës së brendshme të përmendur (14) ndërvendoset të paktën një shirit përforcues (18A, 18B) i prodhuar nga një pëlhurë e tretë, ku shiriti përforcues (18A, 18B) është dizenuar të rrethojë të paktën pjesërisht dhe të mbështesë paketimin balistik të përmendur (24) brenda xhepit përkatës (16A, 16B).

2. Jeleku antiplumb (7) sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që një ose më shumë nga sipërfaqet ngjitëse me forma të përmendura (20) konsiston në të paktën një shtresë ngjitësi poliuretani dhe të paktën një shirit poliuretani.
3. Jeleku antiplumb (7) sipas pretendimit 2, i karakterizuar në atë që një ose më shumë nga sipërfaqet ngjitëse me forma të përmendura (20) konsiston në tre shtresa që mbivendosen, ku dy shtresat e jashtme konsistojnë në ngjitës poliuretani dhe shtresa e ndërmjetme konsiston në një shirit poliuretani.
4. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, i karakterizuar në atë që shtresa e jashtme e përmendur (12) dhe shtresa e brendshme e përmendur (14) janë bashkuar me njëra-tjetrën nëpërmjet ngjitjes në të ngrohtë ose termo-fiksimit.
5. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 4, i karakterizuar në atë që ai përmban :
 - një xhep të parmë (16A), të dizenuar të përmbajë një paketim balistik të përparmë përkatës për të mbrojtur kraharorin e përdoruesit, ku xhepi i parmë i përmendur (16A) është i rrethuar dhe i mbështetur nga një shirit përforcues i parmë përkatës (18A) ; dhe
 - një xhep të pasëm (16B), i dizenuar të përmbajë një paketim balistik të pasëm përkatës për të mbrojtur shpinën e përdoruesit, ku xhepi i pasëm i përmendur (16B) është i rrethuar dhe i mbështetur nga një shirit përforcues i pasëm përkatës (18B).
6. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, i karakterizuar në atë që pëlhura e parë e endur elastike është një pëlhurë bi-elastike e qëndrueshme ndaj vrapit.
7. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 6, i karakterizuar në atë që pëlhura e dytë e endur elastike është një pëlhurë mono-elastike në drejtim të gjerësisë, çka do të thotë përgjatë një drejtimi i cili është kryesisht pingul me shpinën e përdoruesit.
8. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7, i karakterizuar në atë që pëlhura e dytë e endur elastike është një pëlhurë e prodhuar të paktën pjesërisht me poliester.
9. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 8, i karakterizuar në atë që pëlhura e dytë e endur elastike e përmendur është një pëlhurë e trajtuar sipërfaqësisht me një material që ka karakteristika përçuese dhe/ose që ka aftësinë të ndërveprojë me rrezet e kuqe të lëshuara nga trupi i përdoruesit.
10. Jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 9, i karakterizuar në atë që ai përmban një ose më shumë sensorë elektronik (22) me algoritme të përshtatur për të zbuluar parametra specifike fiziologjike dhe biometrike të përdoruesit, ku sensorët elektronik të përmendur (22) janë vendosur në veshje përkatëse në material plastik elastik i bërë tërësisht me shtresën e jashtme të përmendur (12) dhe/ose me shtresën e brendshme të përmendur (14).
11. Një proces për të prodhuar një pëlhurë të një jeleku antiplumb (7) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku procesi është dizenuar të përfshijë një mori shtresash pëlhure nëpërmjet ngjitjes tri-dimensionale, ku procesi përmban hapat si vijon :

- pozicionimin e të përmendurës të paktën një shtresë e jashtme (12) në një shabllon (100) ;
- pozicionimin e të përmendurit të paktën një shirit përforcues (18A, 18B) në shtresën e jashtme të përmendur (12) ;
- ngjitjen e shiritit përforcues të përmendur (18A, 18B) nëpërmjet termofiksimit në shtresën e jashtme të përmendur (12) ;
- pozicionimin e të paktën një një shtrese ngjitësi përgjatë një ose më shumë sipërfaqeve ngjitëse me forma të përmendura (20) ;
- ngjitjen nëpërmjet termofiksimit të një pjese të parë të të paktën të përmendurës një shtresë e brendshme (14), në mënyrë të tillë që të formojë pjesën e jashtme të xhepit (16A, 16B) që përmban dhe mbështet paketimin balistik ;
- pozicionimin e të paktën një shtrese tjetër të ngjitësit përgjatë sipërfaqeve ngjitëse me forma të përmendura (20) ;
- ngjitjen e një pjese të dytë të shtresës së brendshme të përmendur (14) nëpërmjet termofiksimit, në mënyrë të tillë që të formojë pjesën e brendshme të xhepit (16A, 16B) që përmban dhe mbështet paketimin balistik.

(11) **11381**

(97) EP3847087 / 07/12/2022

(96) 19855186.3 / 26/08/2019

(22) 31/01/2023

(21) AL/P/ 2023/49

(54) **MJET NJË RROTËSH**

11/05/2023

(30) 26153418 02/09/2018 IL

(71) Watt Car Industries Ltd.

Micha St., 4, 6311108 Tel Aviv, IL

(72) CAHAN, Amos (207 HAGATOT ST., 9973500 KFAR URJA)

(74) Fatos DEGA

Rr."Nikolla Tupe", N.2, H.4, A.30, Tiranë

(57)

1. Një mjet një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes (100) që përfshin: a. një disk rrote (10) me gomën (15) mbi të; b. një kornizë (30) të rrotullueshme, të montuar brenda kësaj rrote (10); ku kjo kornizë (30) mban një sedilje pasagjeri; c. mjete lëvizëse të konfiguruar për shtyrjen e mjetit një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes të sipërpërmendur; d. mjete frenimi të konfiguruar për të ngadalësuar mjetin një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes të sipërpërmendur; ku mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes i sipërpërmendur (100) përfshin edhe: e. të paktën dy rrota ndihmëse (20) të montuara anash vertikalisht në kornizën e sipërpërmendur (30); f. një njësi kontrolli të konfiguruar për zbulimin e përshpejtimit të aplikuar në mjetin një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes (100) g. një servo-mekanizëm të bashkangjitur të rrota ndihmëse e sipërpërmendur (20), ku rrotat ndihmëse të sipërpërmendura (20) stabilizojnë sediljen e sipërpërmendur të pasagjerit dhe parandalojnë mjetin një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes (100) të sipërpërmendur nga përmbysja anash dhe e mbajnë sediljen e sipërpërmendur të pasagjerit në një pozicion horizontal brenda diskut të rrotës së sipërpërmendur (10); dhe ku rrotat ndihmëse (20) të përmendura janë të zhvendosura në mënyrë sinkronike në të kundërt me drejtimin e lëvizjes, kur mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes (100) përshpejtohet, dhe përgjatë drejtimit të lartpërmendur të lëvizjes, kur mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes (100) ngadalësohet; dhe ku servo-mekanizmi i sipërpërmendur është i kontrollueshëm nga njësia e kontrollit e sipërpërmendur dhe i konfiguruar për zhvendosjen sinkronike të rrotave ndihmëse të sipërpërmendura (20) kur zbulohet një përshpejtim.

2. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku rrotat ndihmëse të sipërpërmendura janë të pjerrtësueshme kundrejt diskut të rrotës të sipërpërmendur gjatë një manovrimi kthese.
3. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku korniza e sipërpërmendur përfshin një mori rulash që kalojnë përgjatë diskut të rrotës së sipërpërmendur.
4. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku mjeti lëvizës i sipërpërmendur përfshin të paktën një lëvizës të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga një motor elektrik, një motor me djegie të brendshme, një lëvizës me energji njerëzore dhe çdo kombinim të tyre; rrotat ndihmëse në fjalë drejtohen individualisht nga mjetet lëvizëse të përmendura.
5. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku disku i rrotës i sipërpërmendur ka një diametër që varion midis 0,5 m dhe 4 m.
6. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 5, ku disku i rrotës i sipërpërmendur ka diametër 2 m.
7. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, i cili përfshin edhe dy sedilje pasagjerësh të montuara në anë, të lidhura mekanikisht me kornizën e sipërpërmendur.
8. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1 që përfshin edhe një mekanizëm të zhvendosjes mekanike të rrotave ndihmëse të sipërpërmendura në mënyrë manuale.
9. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku servo-mekanizmi i sipërpërmendur përfshin një krah të artikulueshëm të konfiguruar për manipulimin e rrotës ndihmëse të sipërpërmendur.
10. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku servo-mekanizmi i sipërpërmendur përfshin një udhërrëfyes dhe një rrëshqitës që mban rrotën ndihmëse dhe të lëvizshme të sipërpërmendur brenda udhërrëfyesit në fjalë.
11. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku servo-mekanizmi i sipërpërmendur përbëhet nga një cilindër hidraulik i konfiguruar për manipulimin e rrotës ndihmëse të sipërpërmendur.
12. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku njësia e kontrollit e sipërpërmendur është e konfiguruar për të kontrolluar në mënyrë dinamike pozicionin e rrotave ndihmëse të sipërpërmendura sipas të paktën një parametri të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga pesha e pasagjerit, gjendja e rrugës, shpejtësia e mjetit dhe çfarëdo kombinimi i tyre.
13. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, që përfshin edhe të paktën një sensor të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga një xhirooskop, një përsheptuesmatës (akselerometër), një imazher dhe çfarëdo kombinimi i tyre; ku të paktën një sensor është i lidhur me njësinë e kontrollit në fjalë.
14. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku mjeti frenues i sipërpërmendur bazohet në mekanizmin e fërkimit.
15. Mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes sipas pretendimit 1, ku mjeti frenues i sipërpërmendur bazohet në një mekanizëm elektromagnetik.
16. Një metodë e përdorimit të një mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes; ku kjo metodë përfshin hapat: a. sigurimi i (dhënia) e mjetit një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes të sipërpërmendur të përbërë nga: i. një disk-rrote me gomë mbi të; ii. një kornizë e rrotullueshme e montuar brenda diskut të rrotës së

sipërpërmendur; ku kjo kornizë mban një sedilje pasagjeri; iii. mjetin lëvizës të konfiguruar për shtyrjen e mjetit një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes të sipërpërmendur; iv. mjetin frenues të konfiguruar për ngadalësimin e mjetit një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes të sipërpërmendur; v. të paktën dy rrota ndihmëse të montuara anash vertikalisht mbi kornizën e sipërpërmendur; vi. një njësi kontrolli; vii. një servo-mekanizëm të kontrollueshëm nga njësia e kontrollit e sipërpërmendur; ku rrotat ndihmëse të sipërpërmendura stabilizojnë pasagjerin në fjalë dhe parandalojnë mjetin një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes nga përmbysja anësore duke e mbajtur sediljen e sipërpërmendur të pasagjerit në një pozicion horizontal brenda dikut të rrotës së sipërpërmendur; dhe ku rrotat ndihmëse të sipërpërmendura janë të zhvendosëshme sinkronikisht në të kundërt me drejtimin e lëvizjes, kur mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes i sipërpërmendur përshpejtohet dhe përgjatë drejtimit të sipërpërmendur të lëvizjes kur mjeti një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes ngadalësohet; dhe ku servo-mekanizmi i sipërpërmendur kontrollohet nga njësia e kontrollit e sipërpërmendur dhe konfigurohet për zhvendosjen sinkronike të rrotave ndihmëse të sipërpërmendura kur zbulohet një përshpejtim; b. vozitja (drejtimi) i mjetit një-rrotësh rezistent ndaj grimcëfutjes i sipërpërmendur.